



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
NDERMARRJA KOMUNALE PLAZH  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_ prot.

Durres më, \_\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** BLERJE VESHJE PUNE

**VLERA E FONDIT LIMIT:**2 082 200 (dy milion e tetedhjetë e dy mijë e dyqind )leke paTvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja Komunale Plazh ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit dhe kualifikimit të parashikuara në piken 1, të shtojcës 7.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021 të paraqitur në autoritetet përkatëse, Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet. Kjo kërkesë konsiderohet e përrmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raportin negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përrmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përrfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë, që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, **ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente të tij**. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nënnt 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikate ISO 9001: 2015 (e vlefshme) ose ekuivalente me të, ”Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së furnizimit me mallra që ofron.

Menaxhimi i cilësisë i certifikuar përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.

Zbatimi dhe certifikimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë sjell besim tek partneret e biznesit dhe autoritetet në lidhje me produktet dhe shërbimet furnizuese duke ndihmuar për zvogelimin e humbjeve dhe përmirësimin e efikasitetit të biznesit në teresi.

ISO 9001 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i perket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit.

**2.3.3** Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë **OEKO-TEX** për tekstilet (ose ekuivalente me to), të vlefshme, të prodhuesit të lëndës së parë. Në rastin kur lëndët e para sigurohen nga prodhues të ndryshëm, certifikata ose dokumenti ekuivalent me të, duhet të paraqitet për të gjithë prodhuesit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nënnt 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Qëllimi i certifikatës së tekstit natyror është një praktikë miqësore me mjedisin dhe me përgjegjësi shoqërore që siguron një prodhim të qëndrueshëm, përfshirë etiketimin nga faza e prodhimit deri në zinxhirin përfundimtar të furnizimit, ndërsa konsideron sigurinë e produktit tek përdoruesi përfundimtar.

Autoriteti kontraktor e vlereson te nevojshme kërkesen e mesiperme për te mos demtuar shendetin e punonjesve.

- 2.3.4** Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues ose distributor i autorizuar nga prodhuesi për artikujt për këtë objekt prokurimi. Në rast se ofertuesi nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave dhe të vërtetohet lidhja midis tyre. Autorizimi duhet të ketë të përcaktuar adresën e saktë të firmës që e ka lëshuar këtë dokument, adresën e postës elektronike, emrin, funksionin e zyrtarit nënshkruar, vulën e shoqërisë (kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi), të jetë i lëshuar për këtë objekt prokurimi dhe për llogari të Autoriteti Kontraktor Ndermarrja Komunale Plazh.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri operatori ekonomik duhet të vërtetoj se ka të drejtat ligjore nga prodhuesi për të ofertuar mallin e kërkuar, origjinale të prodhuara nga prodhuesi. Në rast se ofertuesi e ka marrë të drejtën për të ofertuar mallin e kërkuar nga distributori i autorizuar atëherë, ofertuesi duhet të vërtetojë lidhjen midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Synimi i kësaj kërkesë për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit është garantimi që ofertuesi ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën me autoritetin kontraktor, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar mallra origjinale, me garanci e suport teknik.

- 2.3.5** OE ofertues duhet te paraqese certificate konformiteti produkti per artikujt: Xhup pune me logo dhe Pelerine shiu, sipas standarteve EN 343:2003+A1:2007; EN ISO 20471:2013 ; EN ISO 13688:2013 ne menyre qe te veretohet cilesia e tyre me specifikimet teknike te kerkuara ne DT.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Autoriteti kontraktor e vlereson te nevojshme kërkesat e mesiperme , duke qene se nuk kemi nje specialist tekstili certifikatat e konformitetit dhe raport testimet permbajne te dhenat teknike dhe sipas stanrtave te kerkuara.

- 2.3.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë Autoritetit kontraktor nga një mostër fizike për të gjithë llojet e artikujve, sipas tabelës të përcaktuar në shtojcën 6 të DST.

-Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, **data 09.02 .2023 ora 10:00**, pranë Ndermarrjes Komunale Plazh Plazh Dures, me adresë: Lagja 13, Rruga Dhimiter Kraja

- Mostrat të jenë të shoqëruara me një shkresë, me listë inventarizimi dhe të identifikuara sipas numrit rendor të përcaktuar në shtojcën 6 të DST, e firmosur dhe vulosur nga ofertuesi. Mostrat duhet të kenë të ngjitur nga një etiketë e cila të përmbajë: “Emërtimin i mallit”, numrin rendor të përcaktuar në shtojcën 6 të DST, emrin e ofertuesit, datën dhe orën e zhvillimit të tenderit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

- Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin përkatës nga ofertuesi për paraqitjen e mostrave në emër dhe për llogari të tij.

*Mosparaqitja e mostrave sipas kushteve të caktuara më sipër është kusht për skualifikim.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar, në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. AutoritetiKontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjorë të nxjerra në zbatim të tij, për të kërkuar mostrat e mallrave, objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike, Vetë Komisioni i Prokurimit Publik lidhur me këtë kriter, arsyeton: ...”KPP konstaton se për përmbushjen e këtij synimi, autoritetikontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriteret të tjera kualifikimi, të cilat lidhen me vërtetimin e plotësisë së specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave për disa prej produkteve objekt prokurimi...”Qëllimi i vendosur nga ligjvënësi përparaqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

**Sasia e mallit që kërkohet sipas tebeles se meposhtme**

#### **SASIA E MALLIT**

1	Kostume pune burrash	Pale	50
2	Perparese doku grash	Cope	50
3	Xhup pune me logo	Cope	110
4	Mushama shiu	Cope	130
5	Bluza verore	Cope	80
6	Çizme gome	Cope	130
7	Jelek pune	Cope	360
8	Kominoshe pune verore me logo	Cope	70

9	Kominoshe pune dimri me logo	Cope	60
10	Doreza	Cope	1000
11	Kepuce pune	Pale	60

### LËVRIMI I MALLIT

Të gjithë artikujt do të sillen brënda **15 ditëve** nga lidhja e kontratës, në magazinën e Ndermarrjes Komunale Plazh, Lagja 13 , Rruga Dhimiter Kraja, Plazh Durres, ku do te merren ne dorezim nga komisioni per marrjen ne dorezim te mallit.

### SPECIFIKIMET TEKNIKE

#### 1) Kostum pune burrash (xhakete+pantallona) (logo)

##### a) *Xhaketa*

Materiali 35% pambuk dhe 65% poliester,tekstil, i tezgjahur,me thurje sarzh 2/1, cilesia e larte. Ne pjesen e perparme sipër te kete ne te dy anet nga nje xhep me gjersi 18 cm bashke me kapakun ku kapaku vete eshte 6 cm bashke me fileto, pllak me kapak te cilet kane nje fileto ngjyre jeshile me e celet me gjersi 0.8 mm, ndersa ne pjesen e poshtme dy xhepa pllak me kapak.Mberthimim i kapakeve te behet me butona te zinj me diameter 1.5 mm. Mberthimi ne pjesen e pare te hapur te jete me butona po te zinj me dimesion 1.5 mm. Xhaketa eshte e pajisur me stopan ne supe para dhe shpine mbrapa ku vjen asimetrice si ne pjesen para dhe ne pjesen mbrape duke filluar nga jaka dhe varet deri ku bashkohet me pjeset e mengeve me ngjyre jeshile me e celet, ku ndarja e stopanit me pjesen tjetër behet me nje fileto 0.3 mm ngjyre bezele. Menget jane te pajisura me mansheta me gjersi 4.5 cm e pajisur me 2 percina per regjistrim.Ne pjesen e kurriz te stampohet logoja.Gjatesia e xhaketes do te jete sipas standarteve te xhaketave te kostumeve klasike dhe jo e shkurter.Xhaketa do te jete ngjyre **e verdhe floreshente** .ne pjesen e majte para dhe ne shpine do te jete logoja e ndermarrjes.

Karakteristikat e tekstitiduhettejene:

Dendesia e bazes dhe indit:  $B= 282 \pm, - 2 f/10$  cm;  $I= 202\pm,-2 f/10$  cm

Qendrueshmeria dhe elasticiteti:  $B= 1663$  N  $\epsilon =71$ mm

Qendrueshmeria ne keputje sipas bazes dhe indit:  $I=542$  N  $\epsilon = 41$ mm

Percaktimi i mases: 240 g/m<sup>2</sup>

Trashesia : 0.72 mm

Lageshtira : 5 %

Rezistenca e ngjyres ne larje: 40 grade C Nota 4

Precaktimi i hollesise se fillit:  $NmB=11.5/1$  , $NmI=23.4/1$   
Llojiithurjes: Diagonal Sarzh 2/1

## b) Pantallona

Materiali 35% pambuk dhe 65% poliester, tekstil, itezgjatur, methurjesarzh 2/1, cilesia e larte. Nepjesenballore do teketedyxhepatepjerret, ne pjesenanesoresipergjurit do ketedyxhepate dale tethelle me kapake me gjersi 20 cm dhe lartesi 22.5 cmbashke me kapakunkuvetekapaku me gjersi 7 cm bashke me filetonjeshile me tecelet me gjersi 0,8 mm. Qemeri i pajisur me 7 ylyqe dhe me nje llastik ne pjesen mbrapa per te krijuar nje rehati ne veshje. Ngjyra e pantallonave do te jete **E Verdhe floreshente**

Karakteristikat e tekstitiduhettejene:

Dendesia e bazes dhe indit  $B= 282 \pm, -2 f/10$  cm;  $I= 202 \pm, -2 f/10$  cm  
Qendrueshmeria e permasave  $B= 1663$  N  $\epsilon = 71$ mm  
Percaktimi i mases 240 g/m<sup>2</sup>  
Trashesia 0.72 mm  
Lageshtira 5 %  
Rezistenca e ngjyres ne larje 40 grade C Nota 4  
Precaktimi i hollesise se fillit  $NmB=11.5/1$  , $NmI=23.4/1$ . Sarzh 2/1.

## 2) Perparese(me logo)

Materiali 35% pambuk dhe 65% poliester, tekstil, i tezgjatur, me thurje sarzh 2/1, cilesia e larte. Te kete jake, hapje para dhe mberthimi me percina ne forme unaze me gjersi 1 cm. Ne pjesen e perparme te saj te kete dy xhepa dopjo pllak dhe siper nje xhep ne krahun e majte. Bluzat te jene me menqe te gjata. Ne xhepin e majte lart dhe ne pjesen e kurriz te stampohet logoja e ndermarrjes

Ngjyra: Jeshile

Masa m<sup>2</sup>:  $245 \pm 10$  gram

Trashësia:  $0.44 \pm 0.05$ mm

Lageshtira : 2.1 %

Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 60°C: Nota 4-5

Thurja: Sarzh (diagonal) 3/1

Përbërja fibrore: 35 % Pambuk + 65 Poliester

Dendesia e bazes dhe indit  $B= 514 \pm, -2 f/10$  cm;  $I= 242 \pm, -2 f/10$  cm

Qendrueshmeria dhe elasticiteti  $B= 1463$  N  $\epsilon=45$ mm, ne keputje sipas bazes dhe indit  $I=827$  N  $\epsilon=35$ mm

Precaktimi i hollesise se fillit  $NmB=36.5/1$  , $NmI=28.7/1$

### **3)Xhup pune me logo**

Me 3 shtresa: shtresa e jashtme material polyester oxford WT-300D me veshje PU, mbushja e brendshme vatine 100% polyester dhe astari material tafta PT190T qepur ne forme rombesh. Astari fillon nga pjesa ku mbaron jaka e shtrihet deri 14-16cm ne fundin e xhupit. Ne fund, gjate te gjithë perimetrit xhupi ka nje bordure me materialin e jashtem me trashesi 2-3cm. Astari bashkohet me borduren me te njejtin material si copa e jashtme me nje hapesire 10-15cm.

Mbyllet me zinxhir me 2 togeza. Zinxhiri mbulohet nga nje bordure 7cm dhe mbyllet me 5 precina te barazlanguara 15-17 cm nga njera tjetra. 2 xhepa te jashtem te fshehur – nga nje ne secilen ane me kapake kuti. Xhep i brendshem ne anen e majte me permasa 16.5x15.5cm+/1cm, me mbyllje me velkro. Xhep I fshehur ne anen e majte, qe mbyllet me zinxhir nen borduren qe mbulon zinxhirin e perparme qe eshte I aksesueshem pa hapur zinxhirin kryesor. 2 shirita fosforeshente horizontale 30-34cm larg njera tjetres dhe me 2 shirita fosforeshente vertikale mbi supe. 2 shirita fosforeshente shtese ne secilin krah 28-33 cm larg njera tjetres. Shiritat fosforeshente te jene me gjeresi 5cm. Me kapuc me te njejtin material me shtresen e jashtme te xhupit, qe mbyllet me velkro tek jaka mbrapa dhe me kordon per mberthim kur hapet. Menge te brendshme te fshehura tek lleret me cope te trikotuar llastik me gjeresi 6-7cm. Jaka ne pjesen e qafes e larte 15-16cm. Xhupi me material me shikueshmeri te larte (I verdhe). Certifikuar CE sipas rregullores Europiane 2016/425 standardi EN343:2003+A1:2007 klasi 3/1, EN 13688:2011 dhe EN 20471:2013+A1:2016 klasi 3. Etiketa te kete te dhenat e prodhuesit dhe standardet e mbrojtjes qe ofron. Stampuar me logon e NKP ne gjoks me gjeresi 6-8cm dhe stampe ne shpine me gjeresi 20cm.

### **4)Mushama shiu me shirita fosforeshent material I trashe(logo)**

Tekstil i gomuar (mos pershkueshmeria e ujit 100%)

Ngjyra: **E Verdhe floreshente**

Masa m2: 190± 10 gram

Trashësia: 0.3 ±0.05mm

Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 30°C: Nota 5

Thurja : Garniturë Përbërja fibrore: 62 Polyester + 38% Polyamid.

Materiali te jete element tekstil sintetik i gomuar kundra ujit. Pelerina do te jete e gjate poshte gjurit, me menge te gjata dhe me kapuç.Pjesa ballore me mbyllje me zinxhir te fshehte, i cili nuk duhet te shkoije deri ne fund (mbi 20 cm pa shkuar ne fund ne varesi te masave) me ballome me gjeresi 6cm dhe me 3 (tre) susta syze metalike me diameter 10 mm me dy xhepa te pjerret me fileto, ku gjeresia e filetos 3.5-4cm dhe pjerresia e xhepit ne gjatesi 19-20 cm ngjyre blu.Krahët klasike me dy shirita floureshente rreth krahut me gjeresi 5cm dhe e baraslanguar me distance 5



cm. Kapuci duhet te pershkruhet nga nje kordon rreth kapucit i futur brenda i nje te perthyere 1 cm. Pjesa fundore klasike me nje perthyerje 2 cm. Pjesa e gjoksit dhe pjesa mbrapa ne shpatulla (stopani) duhe te bashkohen me pjeset e mengeve me dy tegela me gjeresi 8-10 mm. te stampohet logo ne shpine.

#### **Parametrat teknike**

- ISO 105 X12 Qendrueshmeria e ngjyres gjate ferkimit
- ISO 105 E04 Qendrueshmeria e ngjyrave gjate djersitjes
- ISO 105 C06 Qendrueshmeria e ngjyres gjate larjes
- ISO 5077 Qendrueshmerise e dimensioneve

OE ofertues duhet te paraqese certifikaten e konformitetit per produktin final të lëshuara ne emer te prodhuesit nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar qe verteton se artikulli i kerkuar eshte ne perputhje me standartet e kerkuara.

#### **5) Bluzaverore**

Bluze verore me tre kopsa, tip polo

100% pambuk

Masa: 180 gr/m<sup>2</sup>

Thurja: trikotazh

Ngjyra: E Verdhe

#### **6) Cizme llastiku**

Çizme gome me ngjyre **blu ose jeshile** me përbërje 100% polivinilklorid (PVC) me një shtresë tekstili push në anën e brendshme, gjatësia e çizmes deri në kupën e gjurit ,e pa depërtueshme nga vaji, me shollë me lule. Material i sholles sitentik i patentuar. Lartesia e cizmes duhet te 33(ne varesi te mases). Lartesia e sholles perpara 1.6 cm dhe ne thember 3 cm. Te jene te prodhuar me PVC. Ti rezistojne ndryshimit te temperatures se ambientit te punes. Te jene te pershtatshme per te punuar ne ambiente me prezence te vajrave lubrifikante, karburanteve, etj. Ngjyra e çizmeve te jete blu ose jeshile Cilesia e larte. Prodhimi i çizmeve te jete bere jo me pare se tre muaj nga koha e levrimit.

#### **7) Jelek fosforeshent (me logo)**

Jelek material poliester, veshje pune reflektive fosforeshente me dy shirita perreth dhe dy shirita vertikal supeve, per nje paraqitje te larte ne pune, rezistente ndaj ujit dhe temperaturave te ulta, praktik e profesionale e modern. Sipas direktives EN 340 te mbrojtjes dhe sigurise ne pune. Me etiketen e firmes prodhuese te trupezuar per udhezimin e perdorimit. **Ngjyra e verdhe**. Ne pjesen e kurriz te stampohet logoja e ndermarrjes

Jelek i thjeshte fosforeshent me copete thurur 100% polyester. Ngjyre e verdhe limoni, Me 2 shirita fosforeshente ne pjesen e barkut, horizontale, paralele rreth 7-9 cm larg njera tjetres.

Mbyllja perpara me velkrof. Pa minge. Certifikuar CE sipas rregullores Europiane 2016/425 standardi EN ISO 20471:2013+A1:2016 klasi 2 (per shikueshmeri te larte) dhe EN ISO 13688:2013. Etiketa me te dhenat e prodhuesit dhe standardet e mbrojtjes qe ofron.

### **8) Kominoshe verore**

Kominoshet te jene verore me rripa, me dy xhepa anesore dhe nje xhep me zinxhir ne pjesen e gjoksit.

Materiali 35% pambuk dhe 65% poliester,teksstil,i tezgjahur,me thurje sarzh 2/1,cilesia e larte

Ngjyre: e Verdhe floreshente

Masa m<sup>2</sup>: 210± 10 gram

Trashësia: 0.44 ±0.05mm

Lageshtira : 2.1 %

Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 60°C: Nota 4-5

Thurja: Sarzh (diagonal) 3/1

Përbërja fibrore: 35 % Pambuk + 65 Poliester

Dendësia e bazes dhe indit B= 514 +,-,2 f/10 cm; I= 242+,-,2 f/10 cm

Qendrueshmeria dhe elasticiteti B= 1463 N ε=45mm,ne keputje sipas bazes dhe inditI =827 Nε = 35mm

Precaktimi i hollesise se fillit NmB=36.5/1 ,NmI=28.7/1

### **9) Kominoshe dimerore**

Tekstil i gomuar (mos pershkueshmeria e ujit 100%)

Ngjyra: E Verdhe floreshente

Masa m<sup>2</sup>: 180 ± 10 gram

Trashësia: 0.3 ± 0.05mm

Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 30°C: Nota 5

Thurja : Garniturë Përbërja fibrore: 62 Polyester + 38% Polyamid.

Pjesa e brendshme me mbushje me vatine 0.5 cm, 100% poliester

### **10) Doreza**

Trashësia: 0,6 –0,8 mm

Qëndrueshmëria e ngjyrës: Nota 4

Hyrja në ujë: 0

Përbërja: 35% pambuk+ 35% polyester+ 30% polyretan

Thurja: Garniture

Masa g/m<sup>2</sup>: 300 ±10

Me thurje najloni me veshje nitrile. Mikroporoze tek pellemba dhe tek gishtat. Pellemba dhe gishtat ngjyre gri, pjesa tjeter e bardhe. Gjatesi normale deri tek kycet. Certifikuar CE sipas

rregullores Europiane 2016/425 standardet EN420:2003+A1:2009 dhe EN388:2016 (4132X).  
Etiketa me te dhenat e prodhuesit dhe te dhenat e mbrojtjes qe ofron.

### **11) Këpuce pune**

Këpuce me qafë, me mbrojtëse metalike, prodhuar nga lëkurë ngjyrë e zezë, rezistente ndaj vajrave, acideve dhe absorbimit të ngarkesave elektrike. Këpucët të jenë të pajisura me shtresë metalike (përforcim mbrojtës) në pjesën e mesme të tabanit të këpucës dhe pjesën e përparme duke i ofruar këmbës një mbrojtje maksimale kundër dëmtimeve gjatë punës me gozhdë, vida dhe peshave të ndryshme që mund të bien mbi këmbë, prodhuar sipas standartit CE EN 20345-1 S1P. Këpucët të plotësojnë standartet europiane të vlefshme për këpucët e sigurisë dhe profesionale.

- Lartësia: 14 cm
- Ngjyra: E Zeze
- Materiali: Lëkurë
- Rezistente ndaj nxehtësisë: Po
- Rezistente ndaj vajrave: Po
- Rezistente ndaj acideve/alkalineve: Po
- Rezistente ndaj rrëshqitjes: Po
- Mbrojtje nga elektriciteti: Po
- Mbrojtje nga goditjet: Po
- Rezistente ndaj ujit: Po

Faqja e këpucës do të realizohet në pesë pjesë (një syprinë, dy faqe, një përforcues dhe një gjuhëz) të bashkuar mes tyre nga qepje me makinë. Qepja duhet të realizohet sipas modelit “tipi klasik me lidhësa dhe majë të gjërë”. Lëkura e përdorur duhet të jetë lëkurë e ngjeshur, e marrë nga pjesët më të mira, të regjura në krom, ngjyrë e zezë ose kafë dhe me trashësi 1.8-2.00 mm.

- Këpuce me qafa me shollëgometëdhëmbëzuar me fortësi 75° Shore
- Përmbajtja e yndyrës: 7%
- Qëndrueshmërianëtërheqje: 2.5kg/mm<sup>2</sup>
- Qëndrueshmërianëfërkim: shumë e mirë
- Qëndrueshmëria e ngjitjes: me termofiksim
- Regjia: shumë e mirë
- Trashësia: 0.9 -1 mm
- Depërtueshmëria e avujve: 1mg/cm<sup>2</sup>

TreguesitFiziko-Kimik (mbasprovavenëlaborator)

- Regjia e lekurëtëjetëshumë e mirë.
- Ngjyrosja jo me pak se nota 8-10.
- Plasaritja jo me pak se 1.55 kg/mm<sup>2</sup>.
- Qëndrueshmëria e faqës gjatë tërheqjes jo me pak se 2.5 kg/mm<sup>2</sup>. □0.2
- Të jenë rezistuese ndaj temperaturës dhe lagështirës jo më pak se 240 minuta.
- Qëndrueshmëria e shollësnëgradë shore jo me pak se 75° Shore

- Rezistenca në shqitje e gomës jo me pak se 30 N (njuton).
- Fortësia e fitilit jo më pak se 1000 g

### **Mënyrat për llogaritjen e vlerës së prokurimit:**

Bazuar në nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në përlllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet ti referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe*
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Grupi i Punës, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë blerje, ka organizuar punën dhe ka ndërmarrë hapa konkret për secilën nga alternativat e përcaktuara në nenin 76 të VKM 285/2021 për llogaritjen e vlerës limit të kontratës ( fondit limit), me qëllimin që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. ***Lidhur me këtë proces, grupi i punës pas përgjigjes së INSTAT -it në te cilën shprehen se nuk disponojnë listë cmimesh per “Blerje veshje pune” nepermjet e-mail zyrtar, ka argumentuar dhe dokumentuar bazuar pikes 1 germa “b” te nenit 76 te ligjit 162/2020 konkretisht:***

- ***Sa i përket respektimit të pikës “b”, Grupi i Punës, bazuar në rregullat e tregut, ka kryer studimin e tregut nëpërmjet marrjës së ofertave, për të njohur për aq sa është e mundur, nivelin e tregut aktual. Operatorët Ekonomik të përzgjedhur në mënyrë rastësore për marrjen e ofertave për testimin e tregut, janë subjekte tregtare të licensuara dhe të regjistruar pranë QKB dhe referuar objektit të veprimtarisë së tyre të publikuara në faqet on-line respektive, por edhe sipas Ekstraktit të Regjistrimit publikuar në faqen zyrtare on-line të QKB, rezultojnë se kanë në objektin e veprimtarisë së tyre, fushen objekt prokurimi.***

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Argumentimi: Specifikimet Teknike të mësipërme janë në përputhje me nenet: Neni 4, pika 38/b të LPP, si dhe nenit 40, pika 2; 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Theksojmë se ‘Specifikimet Teknike’ i shërbejnë AK për të patur garanci se malli i ofruar do të jetë në parametrat dhe në cilësinë e duhur.*

*Shënim: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi janë hartuar nga grupi i punes ngritur me urdher nr 08, date 04.01.2023, miratuar nga titullari i AK, bazuar ne parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhenenit 36, të LPP, si dhe nenit 42 dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Përmiratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo dhe çdo standardi të kërkuar.

**Afati i levrimit: 15 dite nga data e lidhjes se kontrates.**

***Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.***

#### ***NJESIA E PROKURIMIT***

Blerina Gremi

Ersenta Farka

Denisa Rroqja

#### ***GRUPI I SPECIFIKIME TEKNIKE***

Ermal Kapllani

Merita Kasneci

Jolanda Kulla